

# K O N T R A T E

E

## SHOQERISE TREGETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " DIPLOMAT H.Y."

E hartuar sot me dt.15,09,1993 ne Tirane nga partneret:

1. Haxhi Ymeri i biri i Bilalit lindur me 1932 e banues ne Tirane ne Rr" Tefsa Tashko " P.75, ap.3, person madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.
2. Dilaver Ymeri i biri i Haxhiut lindur me 23,10,1961 e banues ne Tirane Rr" Tefsa Tashko" P.75, ap.3, person madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Kjo kontrate u perpilua nga partneret e siperpermendur te cilet ne mbeshtetje te ligjes ne fuqi vendosen per te zvvilluar veprimtari private ne fushen e tregetise si dhe ne fusha te tjera.

### Neni 1.

Partneret do te zhvillojne veprimtarine e tyre nepermjet nje shoqerie te quajtur "DIPLOMAT H.Y." me seli te perhereshme ne Tirane, ne adresen e partnereve.

Ne baze te kontrates ne fjale veprimtaria e shoqerise dhe drejtimi i saj do te behet konform me statutin e shoqerise dhe me legjislacionin Shqiptar ne fuqi.

### Neni 2.

Shoqeria ka per objekt fushen e tregetise per te gjitha produktet kryesisht ne drejtim te hotelerise.

### Neni 3.

Kapitali fillestar i shoqerise eshte 1600 (njemijë) U.S.Dollare Amerikan. Kuotat e pjesmarrjes do te jene nominative dhe te pandashme.

Kapitali shoqeror nenshkruhet dhe depozitohet prane Bankes Tregetare te Shqiperise duke u bazuar ne kuotat pjesmarrese. Partneret kane drejte te shtojne kuotat e tyre ne baze te rregullave te statutit.

### Neni 4.

Te ardhurat e realizuara nga veprimtaria e shoqerise do te ndahen pjeserisht ose totalisht nderrmjet partnereve duke marre parasysh kuotat e tyre te pjesmarrjes. Partneret do te bien dakort per te riinvestuar nga veprimtaria ne veprimtari duke i perdorur sipas vendimit te marre ne mbledhjen e partnereve, pasi te jete ndalur nje kuote per kontribut ne rezerve te rregullt.

Cdo njeri prej partnereve ka te drejte per te transferuar, per te perdorur ose per ta perdorur lirisht pjesen e vet te te ardhurave.

### Neni 5.

Shoqeria duke veruar ne teritorin e Shqiperise ka te drejte te zgjeroje veprimtarine e vet ne bashkepunim me persona juridik shqiptare ose te huaj si brenda ashtu edhe jashte teritorit te vendit.

Neni 6.

Kuotat shoqerore me mareveshje midis te gjalleve mund tu lihen te treteve duke u njohur te drejten e parableries partnerit tjeter sipas statutit.

Neni 7.

Organet drejtuese te shoqerise jane:

- Mbledhja e pergjithshme e partnereve.
- Administratori i vetem ose keshilli administrativ.
- Presidenti i Shoqerise ( Haxhi Ymeri).

Mbledhja do te perfaqesoje universalitetin e partnereve dhe vendimet e saj do te jene konform ligjeve dhe statutit te shoqerise. Partneret mund te perfaqesohen ne mbledhje me ane te personave te tjere vetem sipas ligjit me ane te prokures te legalizuar tek noteri.

Neni 8.

Shoqeria do te administrohet nga nje administrator i vetem ose ng keshilli administrativ i caktuar nga te dy partneret qe do te kene te drejta te plota dhe te gjithaneshme ne administrimin e shoqerise. Keshilli do te perbehet nga numur tek anetaresh per nje kohe jo me shume se tre vjet.

Administratori ruan te drejten ekskluzive te perdorimit te firmes se shoqerise, ndersa e drejta per tu perfaqesuar ne gjykate i takon vetem presidentit te shoqerise ose personave te autorizuar prej tij me prokure.

Neni 9.

Per te gjitha ato probleme per te cilat nuk parashikohen shprehimisht ne kete kontrate do te zbatohen nenet e statutit te shoqerise si dhe dispozitat e legjislacionit shqipetar.

Neni 10.

Cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis shoqerise dhe partnereve si dhe vet partnereve do te zgjidhen migesisht ndermjet tyre dhe kur kjo nu arrihet atehere ceshtja do ti drejtohet gjykates te Rrethit Tirane ku do te zbatohet vetem legjislacioni shqipetar.

Neni 11.

Kjo kontrate eshte perpiluar ne disa kopje dhe ne gjuhen shqipe ne perfundim palet pasi u njohen me permbajtjen e saj e firmosen ate me vullnetin e tyre te plote dhe te lire.

Partneri  
Haxhi Ymeri

Partneri  
Dilaver Ymeri

Avokati  
Dr. Maksim Haxhia



## S T A T U T

### SHOQERISE TREGETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "DIPLOMAT H.Y.:"

Ne mbeshtetje te legjislacionit shqiptar ne fuqi "per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire, veprimtarise private dhe privatizimit", sot me dt. 15, 09, 1993 personat privat Haxhi Ymeri dhe Dilaver Ymeri paraqiten aktin themelues per krijimin e shoqerise tregetare "DIPLOMAT H.Y." duke pranuar statutin qe rregullon menyren e krijimit dhe te funksionimit te saj si vijon.

#### Formimi

#### Neni 1.

Formohet shoqeria e personave privat ne fushen e tregetise e emertuar "DIPLOMAT H.Y." me perfaqesues Haxhi Ymerin dhe Dilaver Ymerin te dy banues ne Tirane.

#### Vendqendrimi

#### Neni 2.

Vendqendrimi aktual ligjor i shoqerise "DIPLOMAT H.Y." do te jete ne Tirane ne nje adrese qe do te zgjidhet nga vet partneret e saj. Me miratime te organeve kompetente shoqeria do te cele filjale ose dege si brenda vendashtu edhe jashte tij.

#### Kohezgjatja

#### Neni 3.

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj per nje periudhe kohe te pakufizuar dhe jo me pak se dhjete vjet.

#### Objekti i veprimtarise

#### Neni 4.

Objekti i veprimtarise te shoqerise "DIPLOMAT H.Y." eshte:

- Ushtrimi i aktivitetit te tregetise vecanerisht ne drejtim te hotele-  
rise.

#### Neni 5.

Shoqeria mund ta ndryshoje emertimin, vendin dhe objektin e veprimtarise mbi bazen e procedurave perkatese qe kerkon legjislacioni shqiptar

#### Neni 6.

Kapitali fillestar i shoqerise perbehet nga 1000 (njemije) U.S. Dollare dhe gjate aktivitetit mund te shtohet ose te pakesohet, ne varesi nga rrethanat e shfaqura gjate ushtrimit te veprimtarise ekonomike te shoqerise. Shoqeria permush te gjitha detyrimet qe rrjedhin nga legjislacioni shqiptar lidhur me sigurimin e detyrueshem te mjeteve motorike dhe te personave

#### Drejtimi

#### Neni 7.

Shoqeria "DIPLOMATIK H.Y." fiton zotesine juridike per te vepruar menjehere pas rregjistrimit te saj si person juridik ne gjykaten e Rrethit Tirane dhe mund te filloje veprimtarine e saj me tu rregjistruar ne organizatatimor perkates.

#### Neni 8.

Shoqeria drejtohet nga te dy partneret te cilet zbatojne kerkesat qe burojne nga ky statut. Shoqeria ka vulen e vet ne te cilen eshte shkruar emertimi i saj si dhe inicialet e emrit dhe te mbiemrit te presidentit te saj.

#### Neni 9.

Gjate ushtrimit te veprimtarise te shoqerise ajo ushtron te drejt:

dhe merr persiper detyrime. Ajo pergjigjet ekskluzivisht per te gjitha detyrimet kontraktore dhe jashte kontraktore brenda kapitalit te saj.

Neni 10.

Perfaqesuesit e shoqerise marrin vendime brenda ketij statuti dhe te legjislacionit ne fuqi gjate ushtrimit te te gjitha veprimtarise se sa gjithnje ne perputhje me objektin e veprimtarise. Te gjitha vendimet e marrane jane te detyrueshme te zbatohen nga personat qe jane punesuar prane kesaj shoqerie.

Neni 11.

Shoqeria me anen e veprimtarise se saj te ligjshme gezon te drejtnepermjet rrugeve te ligjshme te behet pronare e pasurise te luejtshme dhe te paluejtshme si brenda ashtu edhe jashte vendit, Ajo gjithashtu gezon te drejten per te kryer veprimtari te tjera qe kane te bejne me garancite e itekes, me pagesa, depozitime prane institucioneve bankare e financiare. Per te gjitha aktivitetin financiar dhe ecurine e operacioneve e veprimtarive te ndryeshme, personat e ngarkuar me keto detyra duhet te njeftojne perfaqesuesit e shoqerise dhe te japin llogjeron rast pas rasti.

Marrdheniet e Punes

Neni 12.

Drejtuesi i shoqerise per problemet qe lidhen me punesimin eshte i detyruar te njohe dhe te zbatoje legjislacionin perkates ne fuqi ne Republiken e Shqiperise: Ne aktin e punesimit te te gjitha punonjesve ai percakton detyrat dhe te drejtat konkrete si dhe masen dhe menyren e shperblimit. Te punesuarit nga na e tyre detyrohen te zbatojne kete statut te shoqerise pas ai te jete bere i ngohur paraprakisht.

Neni 13.

Marrdheniet e punes rregullohen nepermjet kontratave te punes. Per te gjitha ato pribleme per te cilat nuk gjejne rregullim ne kete statut zbatohen dispozitat e legjislacionit shqopetar. Mosmarreveshjet qe mund te lindin midis punedhensesit dhe te punesuarve zgjidhen en rruge gjyqesore nga gjykata e Rrethit Tirane.

Neni 14.

Te punesuarit prane kesaj shoqerie nuk mund te ushtrojne ne te njejtjen kohe veprimtari konkurruese per llogari te tyre ose te personave te tre perfaqesuar ato qe mund te kryhen me autorizim nga presidenti i shoqerise. Per cdo shkelje ne kete drejtim punonjesi mund te pushohet nga puna dhe nje kohesisht te pergjigjet per demet e shkaketuara.

Sekreti i punes

Neni 15.

Te gjitha te punesuarit prane kesaj shoqerie detyrohen te ruajne sekretin e punes. Sekret pune konsiderohen te gjitha materialet dhe dokumentet qe japin te dhena per dhendjen e shoqerise si; vendime, bilance, plane e informacione, te cilat firmosen nga partneret per tu drejtuar organeve te ndryeshme ose firmave te ndryeshme, etj.

Neni 16.

Detyrimi per te ruajtur sekretin e punes nga te punesuarit ne kete shpqeri mbetet edhe pas largimit te tyre nga puna prane kesaj shoqerie.

Neni 17.

Perfaqesuesit e shoqerise ose i autorizuari prej tyre perfaqesojne interesat e shoqerise ne te gjitha konfliktet gjygesore si dhe ne te gjitha rastet tjera.

Dispozita te tjera

Neni 18.

Shoqeria mund te shperndahet vetem me vendimin e partnereve te saj dhe kur kjo nuk arrihet ata i drejtohen gjykates duke paraqitur edhe shkaqe e shperndarjes se saj. Te gjitha te punesuarit detyrohen te vazhdojne punen deri ne likuidimin e plote te detyrimeve qe ka shoqeria kundrejt te treteve apo organeve shteterore.

Neni 19.

Ky statut i shoqerise "DIPLOMAT H.Y." perpilohet ne disa kopje dhe ne gjuhen shqipe, duke sherbyer si dokument baze per drejtimin e veprimtarise se saj dhe per tua shperndare organeve te ndryeshme sipas kerkesave te legjislacionit shqipertar.

PARTNERI

Haxhi Ymeri



Tirane me 15,09,1993.

PARTNERI

Dilaver Ymeri

